



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Data _____.____.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: "Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara".

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Punime ndërtimi – 45210000-2, Punime ndërtimi për shtëpi – 45211100-0, Riparim dhe renovim – 45453000-7

VLERA E FONDIT LIMIT: 7 784 508.33 (shtatë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e katër mijë e pesëqind e tetë pikë tridhjetë e tre) lekë pa tvsh

Argumentimi i fondit limit: Komisioni i llogaritjes fondit limit dhe specifikimeve teknike për llogaritjen e fondit limit i është referuar nenit 76/1 të pikës (a) të VKM-së me nr.285 datë 19.05.2021 të VKM “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, që përcakton “çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj)”, në VKM nr.216 datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” *(Dokumentuar me relacionin shpjegues të KLLFLST nr. 5709/2 datë 11.07.2025).*

Arsyeja e përdorimit të procedurës së prokurimit “E hapur e thjeshtuar” është sepse fondi limit është nën kufirin e ulët monetar, bazuar në ligjin nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar nenin 49 si dhe në VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar nenin 11, pika 2, gërma b dhe neni 55, 74, 77 si dhe në VKM Nr. 291 datë 15.05.2024 “Për përcaktimin e kufijve monetare në procedurat e prokurimit” Kreu II pika 2/a.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2 pika 2/c dhe nenit 78 pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të

prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Roskovec ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

Kërkesa për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar neni 83 pika 1 si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni II, Neni 30 pika 1.

Këto kriterë janë vendosur për të vertetuar pjesëmarrjen ose jo të operatorit ekonomik në tendera, duke paraqitur oferte. Gjithashtu këto kriterë janë vendosur edhe për të vërtetuar deklaratimet dhe dokumentat e paraqitura nga operatorët ekonomik, duke kaluar tërësisht përgjegjësinë administrative ose penale gjithashtu barrën e proves tek operatorët ekonomik për dokumentat e paraqitura.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme sipas shtojcës 7.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1/a dhe 2 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar; nenin 40 pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së perlllogaritur të kontrates, **perkatesisht 3 113 803 lekë pa tvsh.**

Kriteri konsiderohet i përmbushur nese operatorët ekonomik arrijne vleren e xhiros minimale ne te pakten 1 (nje) vit te periudhes se kerkuar te viteve financiare.

Argumentimi: Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke patur në konsideratë vlerën e objektit të prokurimit: **“Permiresim i banesave ekzistuese per komunitete te varfere dhe te pafavorizuara ”** neni 77 pika 3 e Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe nenin 43 pika 3 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për

miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se: *”Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar..”*, Vendosja e këtij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në përputhje me Ligjin nr.10091 datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c.

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 3 e Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në nenin 43 pika 1, 2/c, 4 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës konkretisht, Ligjit nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar. Autoriteti Kontraktor mund të kërkojë nga OE pjesëmarrës në një procedurë prokurimi të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojë raportet nëpërmjet aktivit dhe pasivit. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5 datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar nenit 29 të ligjit nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore” i ndryshuar: *“Çdo tatim-pagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatim-paguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave, në zbatim të këtij ligji”*.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve vjetore është bërë bazuar në VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar e cila parashikon se Autoriteti Kontraktor për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike mund të kërkojë për një periudhë maksimumi deri në 3 vitet e fundit financiare. Kjo është një kërkesë e cila nuk e pengon konkurrencën dhe është e bazuar në garancinë që ofertuesi i paraqet Autoritetit Kontraktor.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024 si dhe kestet e maturuara të vitit 2025, në zbatim të Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB).

Ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes se Formularit Permbledhes te Vetedeklarimit sipas shtojces 8 ne DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43 pika 6 të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar si dhe sipas Ligjit Nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Referuar sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj. Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar që operatorët ekonomikë nuk kanë pagesa të pashlyera të taksave dhe tarifave vendore.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Ose

b) Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, të jetë jo më e vogël se vlera limit e kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike, **Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse **pika 2.3.1/b** duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontratë Sipërmarrje
- Situacionin përfundimtar

- Akt i kolaudimit
- Formular vleresimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9;

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontrate Sipërmarrje;
- Situacion/faturë tatimore; (te deklaruar ne organet tatimore)
- Akt i kolaudimit
- Formular vleresimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9;

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e bashkimit të operatorëve të deklaruar në fazën e tenderimit.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontratën baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin nga ana e Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; dhe në nenin 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës që prokurohet.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1, 3 e VKM 285/2021 e ndryshuar, parashikon se (pika 1): “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve”. (pika 3): “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. 65 Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht”.

AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave të mesipërme, të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike/private të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me *Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi"* i perditesuar e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Nr.	Licenca	Kategoria e kryerjes së punimeve
1	NP1-A	Punime gërmimi në tokë
2	NP3 - A	Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada
2	NS4-A	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese
4	NS14-A	Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV etj.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, datë 16.01.2008 i perditesuar).

Mosparaqitja ne kete forme eshte kusht skualifikues.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, nenin 39 pika 6/a të VKM nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, ku parashikohet se: *"Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga organet kompetente shtetërore"*, si dhe në klasifikimin e niveleve (gërmave) për punimet sipas natyrave respektive, të parashikuara në VKM Nr.42 datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", i ndryshuar. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit Nr. 8402 datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar neni 8 përcakton: *"Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi*

dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane. Referuar kategorive të kërkuara, Autoriteti Kontraktor argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

Shpjegime për kategoritë e ndërtimeve (punimeve) të përgjithshme.

Kategoria NP-1 A (Punime gjurmimi në tokë)

- Konsiderohen gjurmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjurmohet ose sistemohet, vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

Kategoria N.P-3 A (Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada).

- Konsiderohen zgjidhjet dhe koordinimi i punimeve të specialiteteve të nevojshme për riaftësim, konservim, konsolidim, transformim, rivlerësim, ristrukturim. Konsiderohen gjithashtu dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.

Kategoria N.S-4 A (Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese)

- Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i muraturës dhe mureve ndarës të çfarëdo lloji, tipi, përfshirë suvatimin, patinimin, bojatisjen dhe punime të ngjashme me to. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i karpenterisë dhe punimeve prej druri, të dyerve dhe dritareve të brendshme dhe të jashtme, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme të dysHEMEVE të tipave të ndryshme dhe me materiale të ndryshme dhe të punimeve të realizuara me dorë, me metal, dru, material plastik dhe material xhami ose të ngjashëm. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i izolimit termik dhe akustik, nënçatitë dhe mbrojtja nga zjarri, izolimi i natyrave të ndryshme dhe me materiale të ndryshme.

Kategoria N.S-14 A (Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV)

- Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe të linjave të transmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t'u realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme

KATEGORITË E KËRKUARA JANË KËRKUAR NË BAZË TË ZËRAVE DHE VLERAT E PUNIMEVE SI ME POSHTË:

KATEGORIA	Pershkrimi i kategorise sipas legjislacionit te fushes	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kerkuar per kategorinë e respektive
<u>N.P. 1-A</u>	Punime gërmimi në tokë	Germim themele e plinta b>2m, ekskavator me goma, kova 0.25m3, shkarkim auto Hedhje, rrafshim, mbushje dheu me krah, kategoria III	Niveli A (0-20 milion) lekë
<u>N.P-3 A</u>	Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.	Prishje muri Shtrese zhavori lumi t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri - 2 shtresa Shtresë betoni C12/15 nen themele t=10cm nen pllake Trare themeli monolit b/a C - 16/20 Kollona b/a monolite C - 16/20, h ~ 4 m Trare e arkitrare b/a C - 16/20, h ~ 4 m Brez b/a C20/25 Soleta te plota b/a C 20/25 t = 10 cm, h ~ 4m F.V. hekur betoni i zakonshëm Ø~10 F.V. hekur betoni i zakonshëm Ø>10 Shtrese betoni C=7/10 per nenshtresen Plintuse grez h = 10 cm Shtrese me pllaka grez importi, 40x40cm Mur tulle t=25cm I lehtesuar Çati vendi e zakonshme me HD~8m, tjegulla marseljeze Tavan I varur me pllaka 60x60cm Suva brenda mur tulle h~4m me pompe, llaç perzier M 25 Suva e zakonshme fasade mur tulle h ~ 8 m	Niveli A (0-20 milion) lekë
<u>N.S-4 A</u>	(Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, me rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese)	Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 1 shtrese k katrama Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 3 k katrama F V Dritare d/alumini dyfish xham dritare F V Dritare d/alumini dyfish xham dyer kryesore F V Dritare d/alumini dyfish xham dyer brendshme Boje hidroplastike sip.e brendeshme	Niveli A (0-20 milion) lekë

N.S-14 A	Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV	F.V. Tub elektrik plastmasi 18-26	Niveli A (0-20 milion) lekë	
		F.V. Percjelles Ø 4mm		
		F.V. Percjelles Ø 2.5mm		
		F V Celesa dhe priza 10A me nulifikim		
		F.V. Portollampa		
		F.V. Çeles automat termo-elektro magnetik 2P;20A;220V		
		F.V. Kuader ndricimi		
		F.V. Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 16A		
		F.V. Kuti derivacioni plastike		
		F.V. Elektroda tokezimi, profil zingato e bakerizuar, L=1.5m		

Klasifikimi sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi i referohet Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” i ndryshuar

2.3.3.a. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si dhe te **figurojë në listëpagesat e shoqërisë për muajin e fundit** si më poshtë:

- Inxhinier Ndertimi 1 (një)

Për te cilin duhet të paraqiten:

- Kontratë punë e vlefshme
- Diploma
- CV
- Licence

** Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjesin e kerkuar si me siper, emer/mbiemer, numrin dhe daten e certifikates, si dhe institucionin qe ka leshuar kete dokument.*

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Së pari, kjo kërkesë mbështetet ne ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”i ndryshuar neni 77 pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39 pika 6 gërma “c”.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e

nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **drejtues teknik** të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

Kriteri për stafin teknik kryesor, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinier në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Stafi i inxhinierëve është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

Inxhinieri i Ndërtimit është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar punimeve të parashikuara në preventiv dhe projekt.

2.3.3.b. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar dhe të figurojnë në listëpagesat e subjektit për muajin e fundit, punonjësit specialistë të kualifikuar, si më poshtë:

EMERTIMI	
Elektriçist	(1 person)
Usta montues dyersh/dritarësh alumini	(1 person)
Suvatues	(1 person)
Pllakashtrues	(1 person)
Murator	(1 person)
Bojaxhi	(1 person)

Për punonjësit me profesionet si më sipër, në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të ketë mundësinë e verifikimit, Operatorët Ekonomikë duhet të plotësojnë dhe ngarkojnë tabelën e mëposhtme me të dhënat e sakta që i përkojnë diplomës/certifikatës së formimit profesional nga Institucione Private apo Shtetërore, të cilat regjistrohen në bazën e të dhënave të AKPA-së pranë Ministrisë së Financave (Institucioni përgjegjës për formimin profesional).

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Nr amzes/regjstrit dhe data e lëshimit	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1					
2					
etj					

Për punonjësën e kualifikuar si më sipër, ofertuesi duhet të paraqesë:

- Kontratën individuale të punës;
- Një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara /akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesat e pikes **2.3.3.b** janë bazuar në nenin 77 pika 4 e Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenin 39 pika 6/c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional në R.SH”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- 1 (nje) Elektriçist është i nevojshëm për ndjekjen e realizimin e punimeve elektrike, referuar zerave te preventivit.
- 1 (nje) Usta montues dyersh/dritaresh alumini- është i nevojshëm për zëvendësimin ose instalimin e dyerve dhe dritareve të reja prej alumini referuar zerave te preventivit.
- 1 (nje) Suvatues – është i nevojshëm për rrafshimin dhe perfundimin e mureve të brendshme dhe të jashtme referuar zerave te preventivit.
- 1 (nje) Pllakashtrues - është i nevojshëm për shtrimin e pllakave referuar zerave te preventivit.
- 1 (nje) Murator - është i nevojshëm për ndërtim, riparim ose ristrukturim të mureve dhe elementeve mbajtës referuar zerave te preventivit.
- 1 (nje) Bojaxhi - është i nevojshëm për lyerjen dhe rifreskimin e sipërfaqeve të brendshme dhe të jashtme të banesës referuar zerave te preventivit.

2.3.3.c. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të dëshmojnë se kanë të punësuar në stafin e shoqërisë punonjës të kualifikuar, të pajisur me Dëshmi të Aftësive Profesionale (DAP), lëshuar nga D.P.SH.T.RR. **minimalisht** si më poshtë:

- Shofer 1 (një)

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Kontratën e punës të vlefshme;
- Dokument (dëshmi kualifikimi profesional), që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me Urdhërin nr. 200 datë 16.5.2019 të Ministrit të Infrastruktursë dhe Energjitikës.

** Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjësit e kërkuar si me sipër, emer/mbiemer, numrin dhe datën e deshmisë së aftësisë profesionale.*

****(Në rastet kur mjetet/makineritë disponohen me qera, këta punonjës mund të jenë të kontraktuar).***

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 e Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe nenit 39 pika 6/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)” të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

- **1 (nje) Shofer** është i nevojshëm për manovrimin e mjeteve që do të përdoren gjatë zbatimit të punimeve. Bazuar në orët e punës që dalin nga zberthimi zë më zë i preventivit, afatit të punimeve si dhe sasisë së materialeve që do të transportohen rezultojnë të nevojshëm 1 shoferë.

2.3.3.d. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë **5 punëtorë të thjeshtë**, për të cilët të paraqiten kontratat e punës si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë minimalisht për muajin e fundit kur janë pjesë e stafit të shoqërisë ose kur janë siguruar nga operatori ekonomik me anë të marrëdhënies kontraktore për ekzekutimin e kontratës objekt prokurimi nuk kërkohet të figurojnë në listëpagesat perkatese.

Ne rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet të paraqesë punonjësit e mësipërm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 28, datë 19.05.2021 i ndryshuar, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë llogaritur nepermjet analizave teknike nga anetarët e Njesise së Prokurimit me profil inxhinier ndërtimi, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht Vendimit Nr. 216 datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”. Numri i punëtorëve është si rezultat i analizës teknike që kanë antarët e Njesise së Prokurimit me profil inxhinier, të cilët kanë kryer llogaritë perkatese.

2.3.3.e.Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht **13 (trembedhjetë) persona të pasqyruar në listëpagesën e muajit e fundit**, (janë të përfshirë 1 (nje) inxhinier ndërtimi (drejtuesi teknik) + 1 (nje) elektrikist + 1 (nje) Usta montues dyersh/dritaresh alumini + 1 (nje) suvatues +1 (nje) pllakatshtrues + 1 (nje) murator +1 (nje) bojaxhi + 1 (nje) shofer + 5 (pese) punetor te thjeshte).

Për përmbushjen e këtij kushti operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve per muajin e fundit.
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi per muajin e fundit.

(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike kjo pikë duhet te plotesohen nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me natyrën e punimeve dhe përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje).

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentim: Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77 pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar në të cilin thuhet: “*Aftësia profesionale e operatoreve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës*”. Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve, tregon besueshmëri për Autoritetin Kontraktor. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument qe vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatoreve ekonomik, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim prej 13 (trembedhjetë) punonjes është në përputhje me volumin e punës, natyrën, ku do të kryhen punimet. Po t’i referohemi projektit, preventivit, është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë Autoritetit Kontraktor për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatoreve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39 pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, sipas së cilës: *”Autoriteti/enti Kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*.

2.4. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Lloji i makinerive	Njësia	Sasia	Statusi
1	Kamion vetëshkarkues	Copë	1	Në pronësi ose me qira
2	Autobetoniere	Copë	1	Në pronësi ose me qira
3	Eskavator	Copë	1	Në pronësi ose me qira
4	Kamioçinë	Copë	1	Në pronësi ose me qira
5	Autobot uji	Copë	1	Në pronësi ose me qira
6	Vibrator betoni	Copë	1	Në pronësi ose me qira
7	Vinc	Copë	1	Në pronësi ose me qira
8	Pompe suvatimi	Copë	1	Në pronësi ose me qira
9	Skela	m ²	450	Në pronësi ose me qira
10	Jelek	Copë	15	Në pronësi ose me qira
11	Kokore	Copë	15	Në pronësi ose me qira

- Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme).*
- Për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit te vlefshme), duhet te shoqerohet me kontraten perkatese te qerese e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.*

- c) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, si kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore perkatese.
- d) Autoriteti Kontraktor gezon te drejten te verifikojë dhe kontrollojë disponueshmerine e ketyre mjeteve si gjate vleresimit te ofertave ashtu edhe gjate zbatimit te kontrates.
- e) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit dhe Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruara ne procedura te shpallura fitues.

(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike pikat e kriterit 2.4 duhet te plotesohen nga secili anëtar i bashkimit, **në përputhje me natyrën e punimeve dhe përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje).**

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, **i ndryshuar**, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 e Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe nenit 39 pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Mjetet dhe pajisjet e kërkuara janë vendosur në proporcion me zërat dhe volumet e punimeve dhe afatin e përlllogaritur për realizimin e kontratës objekt prokurimi. Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronësi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i’u referuar punimeve sipas standardeve, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekt zbatimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

2.5. Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se e zhvillon aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë. Për këtë duhet të paraqesin certifikatën e mëposhtme:

- **Çertifikatë ISO 9001:2015 (Sistemet e menaxhimit te cilësisë)** ose ekuivalente (e vlefshme)
- **ISO 45001:2018 (Sistemi i Menaxhimit te Sigurise dhe Shendetit ne Pune)** ose ekuivalente (e vlefshme).

Certifikatat të jenë të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike kjo pikë duhet te plotësohen nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me natyrën e punimeve dhe përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje).

Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas nenit 79 pika 1 e ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuarku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë” si dhe ne zbatim te nenit 44 pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

Autoriteti Kontraktor gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Çertifikatat e kërkuara është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Çertifikata e kërkuara janë në përpjestim me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve.

ISO 9001:2015 është kërkuar me qëllim vërtetimin e efektivitetit dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së operatorit ekonomik, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove, duke bërë të mundur që ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 45001:2018 është kërkuar me qëllim vërtetimin e aftësisë së operatorit ekonomik në lidhje me vlerësimin e rrezikut dhe përgatitjen e punonjësve duke i ushtruar dhe trajnuar ato me qëllim për të minimizuar/eliminuar rreziqet të cilat u ekspozohen gjatë kryerjes së punimeve, si një detyrim ligjor, ku veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci shtesë që do të sjellë reduktimin e aksidenteve

2.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit (Bashkëlidhur DST) të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit për 6 (gjashtë) muaj kalendarike.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39 pika 3. Ky kriter vendoset me qëllim që të përcaktohet në mënyrë të qartë shpërndarja e fuqisë puntore dhe e mjeteve me anë të një grafiku punimesh.

2.7 Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet: *“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”*, si dhe përcaktimet e pikës 6 të këtij neni ku parashikohet: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 26 pika 1 e VKM-së, nr.285 datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar .

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Punimet objekt prokurimi, të cilat shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, bazohen në parashikimet e nenit 4, nenit 36 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe nenit 39 pika 2, të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Specifikimet teknike të këtij objekti prokurimi janë përcaktuar nga Komisioni i posacëm: KLLFLST, sipas materialit bashkëlidhur ne SPE.

U ra dakort nga antaret e Njesisë së Prokurimit të ngritur me urdher të titullarit të Autoritetit Kontraktor **nr.78 date 15.07.2025**, për këto kërkesa për kualifikim pasi kërkesat e mësipërme janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës që është: **"Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara"** me fond limit prej: **7 784 508.33 (shtatë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e katër mijë e pesëqind e tetë pikë tridhjetë e tre) lekë pa tvsh**, lloji i procedurës: **E hapur e thjeshtuar**.

Ato do të shërbejnë për njohjen e plotë të gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës .

Kërkesat e veçanta të kualifikimit të mësipërme përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me LPP dhe VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kriteret e hartuara janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Për secilin kriter janë përcaktuar dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e atyre kriterëve.

Argumentim: Anëtarët pranuën specifikimet teknike të hartuara nga Komisioni i posacëm: **KLLFLST (Komisioni i llogaritjes të fondit limit dhe specifikimeve teknike)** i ngritur me Urdhër të titullarit të Autoritetit Kontrakt nr. 5709 prot datë 01.07.2025, duke konsideruar se ato shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor për shërbimet që do të realizoj. Preventivi është hartuar nga specialistet e fushës konkretisht nga KLLFLST, dorëzuar dokumentacioni teknik si **Procesverbali i Komisionit nr. 5709/1 prot datë 11.07.2025** si dhe **Relacioni shpjegues nr. 5709/2 prot date 11.07.2025** si dhe Projektin, **specifikimet teknike, relacioni teknik** të cilat shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve.

Preventivi i hartuar nga KLLFLST si më poshtë për objektin: "Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara"

PREVENTIV

Nr	Nr.An.	Lloji i punimeve	Njësia	Sasia
PUNIME NDERTIMI				
1	2.426	Prishje muri	m ³	6.0
2	2.26	Germim themele e plinta b>2m, ekskavator me goma, kova 0.25m ³ , shkarkim auto	m ³	50.3
3	3.205/2	Shtrese zhavori lumi t=20cm, përhapur e ngjeshur me makineri - 2 shtresa	m ³	57.0
4	2.262/4b	Shtresë betoni C12/15 nën themele t=10cm nën pllake	m ³	3.1
5	2.196	Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 1 shtrese k katrama	m ³	38.0
6	2.198	Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 3 k katrama	m ²	284.0
7	2.19	Hedhje, rrafshim, mbushje dheu me krah, kategoria III	m ³	5.0
8	2.116	Trare themeli monolit b/a C - 16/20	m ³	4.8
9	2.117	Kollona b/a monolite C - 16/20, h ~ 4 m	m ³	2.4
10	2.119	Trare e arkitrare b/a C - 16/20, h ~ 4 m	m ³	1.4

11	2.116	Brez b/a C20/25	m3	24.1
12	2.122/1a	Soleta te plota b/a C 20/25 t = 10 cm, h ~ 4m	ton	4.5
13	2.166	F.V. hekur betoni i zakonshëm Ø~10	m³	1.7
14	2.166/1a	F.V. hekur betoni i zakonshëm Ø>10	m²	1.2
15	2.262/1	Shtrese betoni C=7/10 per nenshtresen	m²	1.5
16	2.324/b	Plintuse grez h = 10 cm	ml	39.0
17	2.267/b	Shtrese me pllaka grez importi, 40x40cm	ml	33.0
18	2.70/2	Mur tulle t=25cm I lehtesuar	m²	6.6
19	2.219	Çati vendi e zakonshme me HD~8m,tjegulla marseljeze	m2	961.1
20	2.297/b	Tavan I varur me pllaka 60x60cm	m2	214.7
21	2.375/a	F V Dritare d/alumini dyfish xham dritare	m²	12.2
22	2.375/a	F V Dritare d/alumini dyfish xham dyer kryesore	m³	5.0
23	2.375/a	F V Dritare d/alumini dyfish xham dyer brendshme	m³	5.6
24	2.310/1	Suva brenda mur tulle h~4m me pompe, llaç perzier M 25	ml	243.4
25	2.331	Suva e zakonshme fasade mur tulle h ~ 8 m	m²	102.0
26	2.404	Boje hidroplastike sip.e brendeshme	m²	545.8
SHUMA 1				
PUNIME ELEKTRIKE				
1	2.480/2	F.V. Tub elektrik plastmasi 18-26	ml	30
2	2.481/3	F.V. Percjelles Ø 4mm	ml	15
3	2.481/2	F.V. Percjelles Ø 2.5mm	ml	24
4	2.485	F V Celesa dhe priza 10A me nulifikim	copë	12
5	2.486	F.V. Portollampa	copë	6
6	2.530	F.V. Çeles automat termo-elektro magnetik 2P;20A;220V	copë	3
7	2.490	F.V. Kuader ndricimi	copë	3
8	2.490/1b	F.V. Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 16A	copë	6
9	2.487	F.V. Kuti derivacioni plastike	copë	9
10	2.496	F.V. Elektroda tokezimi, profil zingato e bakerizuar , L=1.5m	copë	3

SHUMA 2
SHUMA 1+2
T.V.SH 20%
TOTAL NE LEKE

Dokumentacioni pasi u firmos nga të tre anëtarët e Njesisë së Prokurimit, pasi u përpilua edhe formulari përmbledhës i njoftimit të kontratës, do ti paraqitet titullarit të autoritetit kontraktor për t'u firmosur dhe u ra dakort që të hidhen në formatin e sistemit elektronik nga personi përgjegjës i prokurimeve anëtar i NJ.P, për shpallje dhe botim nga APP.

NJËSIA E PROKURIMIT